



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:192152

Datë: 28.05.2024

Numri i dokumentit: 05747254

KPPP.nr.612/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Hasan Kryeziu, në çështjen përbarimore të kreditorit Ministria e Infrastrukturës - Drejtoria e Rrugëve të Kosovës, me NUI: 80245734, me seli në rr. “Hamid Kokalari” pn, në Prishtinë, kundër debitorëve 1. Ndërmarrja Tregtare Prodhuese “AGONISI GAS”, me NUI: 810338691, me seli në Fshatin Carabreg, në Deçan, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Teki Bokshi, avokat nga Gjakova dhe 2. M.L., me adresë në Fshatin ..., në Deçan, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përbarimor P.nr.757/23 të datës 27.10.2023 të Përbaruesit Privat Valdrin Beka me seli në Prishtinë jashtë seancës, me datë 28.05.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit 1. Ndërmarrja Tregtare Prodhuese “AGONISI GAS”, ANULOHET Urdhri Përbarimor P.nr.84/18 i datës 08.02.2018, i Përbaruesit Privat Valdrin Beka dhe PËRFUNDOHET në tërësi përbarimi në këtë çështje përbarimore.

A r s y e t i m

Përbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Ministria e Infrastrukturës - Drejtoria e Rrugëve të Kosovës, ka lëshuar urdhrin përbarimor P.nr.84/18 të datës 08.02.2018, me të cilin ka lejuar përbarimin në bazë të dokumentit të besueshëm - Faturës Nr. B-72/2015 të datës 12.11.2015 dhe Faturës Nr. B-72/2014 të datës 12.11.2014 me të cilin e ka urdhëruar debitorin që pas pranimit të këtij urdhri t'i paguajë kreditorit shumën prej 2,100.00 €, me kamatëvonesë prej 8 % në vit, duke e llogaritur nga data kur kërkesa është bërë e arritshme e deri në pagesën definitive, si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përbarimore, ashtu që

këto detyrime të realizohen përmes zbatimit të përmbarimit sipas llogarive bankare të debitorit dhe bartjen e tyre në llogarinë e veçantë të përmbaruesit privat, si dhe me sekuestrimin e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit dhe me shitjen e tyre të bëhet inkasimi i borxhit në llogari të kreditorit.

Debitorët në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, përmes përfaqësuesit të autorizuar, kanë kundërshtuar urdhrin përmbarimor, me arsyetimin se propozimi i kreditorit nuk është i rregullt dhe se në faturat e bashkëngjitura është faturuar sipërfaqja prej 525 m² e cila nuk është reale. Më tutje shtuar se kërkesa e kreditorit është parashkruar. I ka propozuar gjykatës që ta lë jashtë fuqie urdhrin për lejimin e përmbarimit dhe të detyrohet kreditori që të paguaj shpenzimet e procedurës përmbarimore.

Kreditori nuk ka paraqitur përgjigje në prapësim.

Gjykata Themelore në Pejë - Dega në Deçan lidhur me këtë çështje përmbarimore me Aktvendimin EP.nr.05/18 të datës 03.06.2020 e ka refuzuar prapësimin e debitorit dhe e ka lënë në fuqi Urdhrin Përmbarimor P.nr.84/18 të datës 08.02.2018.

Gjykata e Apelit e Kosovës, me Aktvendimin Ac.nr.2867/20 të datës 28.04.2021 ka aprovuar si të themeltë ankesën e debitorëve dhe ka prishur aktvendimin EP.nr.05/18 të datës 03.06.2020 të Gjykatës Themelore në Pejë - Dega në Deçan dhe e ka kthyer lëndën në rishqyrtim dhe rivendosje.

Gjykata Themelore në Pejë - Dega në Deçan, në rivendosje me Aktvendimin EP.nr.5/18 të datës 10.07.2023 e ka aprovuar prapësimin e debitorit dhe e ka anuluar Urdhrin Përmbarimor P.nr.84/18 të datës 08.02.2018.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Dytë, me Aktvendimin K.DH.SH.II.nr. 253/24 të datës 25.03.2024 e ka aprovuar ankesën e kreditorit, dhe ka prishur Aktvendimin EP.nr.05/18 të datës 10.07.2023 të Gjykatës Themelore në Pejë - Dega në Deçan dhe lëndën e ka kthyer në rivendosje në Gjykatën Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit dhe kreditorit, vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe vërejtjeve të dhëna sipas aktvendimit të Gjykatës Komerciale si dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për

Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) dhe nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 Për Procedurën Përmbartimore, gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbartimor duhet të anulohet dhe procedura përmbartimore të përfundohet në tërësi për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se në rastin konkret Fatura Nr. B-72/2015 të datës 12.11.2015 dhe Fatura Nr. B-72/2014 të datës 12.11.2014, në bazë të së cilave është lejuar urdhri përmbartim, nuk i plotësojnë kushtet e parapara me nenin 29 dhe nenin 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*, kurse me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*, ndërsa sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se dokumenti - fatura në bazë të së cilës është lejuar propozimi për përmbartim nuk i plotësojnë kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për faktin se këto fatura në rastin konkret janë lëshuar në mënyrë të njëanshme nga ana e kreditorit dhe nuk janë pranuar nga debitori, përkatësisht të njëjtat nuk përmbajnë nënshkrimin e pranuesit - debitorit dhe nuk kanë dëshmi se janë pranuar nga debitori në çfarëdo forme. Andaj duke qenë së debitori nuk i ka pranuar në mënyrë të rregullt këto fatura, të njëjtat nuk mund të shërbejnë si dokument i besueshëm.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumenti mbi të cilat mbështetet propozimi për përmbartim, e mbi bazën e të cilit Përmbartuesi Privat ka lejuar përmbartimin, nuk mund të shërbejnë si dokument i besueshëm pasi që nuk kanë tipare të përmbartueshmërisë.

Gjykata në kuptim të nenit 71 par. 1.1 dhe 73 të LPP-së, nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.612/24, datë 28.05.2024

Gjyqtari
Hasan Kryeziu

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimin të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.